



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**“UJESJELLES MAT” Sh.a.**

Adresa : Lagja “Partizani”, Rruga “Ibrahim Temo”, Ndertesa Nr 6 ujesjellesmat.sha@gmail.com Tel : +355 217 22542

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Burrel, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
***(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)***

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “E.B.S” Sh.p.k**, me numër Nipt-i: **K72014002P**, me seli:  
*Tiranë, Kashar, YZBERISH, Rruga "Teodor Keko", pallati "ALES Konstruksion", shkalla nr.1, kati 7-të.*

Procedura e prokurimit: “E Hapur, E Thjeshtuar - Shërbime”, prokurim elektronik.

Numri i referencës së procedurës: REF-47875-10-30-2022.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Mbikqyerje të punimeve për investimin me objekt:** “Ndërtim ujësjellësi për furnizimin me ujë të fshatrave të Njësisë Administrative Derjan dhe Rukaj, Loti III”, me fond limit në vlerën: prej **1 993 797** (një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH** nga buxheti i shtetit, ndarë për vitin 2022 në vlerën: 398 759.16 (treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për vitin 2023 në vlerën: 598 139.16 (pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, ndërsa për vitin 2024 në vlerën: 996 898.33 (nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, me afat realizimi: **6 (gjashtë) muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit** (i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet).

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 152, datë 7 Nëntor 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori Ekonomik: “E.B.S” Sh.p.k.,**

**me numër Nipt-i: K72014002P**

Vlera: **1 791 323** (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e njëzet e tre) **lekë pa TVSH.**

2. Operatori Ekonomik: “**NOVATECH STUDIO**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L01717030C**

Vlera: **1 791 322.88** (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e njëzet e dy pikë tetëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

3. Operatori Ekonomik: “**INSTITUTI DEKLIADA - ALB**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71606006A.**

Vlera: **1 791 322** (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e njëzet e dy) **lekë pa TVSH.**

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Operatori Ekonomik: “**NOVATECH STUDIO**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L01717030C.**
2. Operatori Ekonomik: “**INSTITUTI DEKLIADA - ALB**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **K71606006A.**

***Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:***

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “NOVATECH STUDIO” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:**

**I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.5/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

*Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar në stafin e tij për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, librezë pune, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.4, stafi inxhinierik si më poshtë:*

- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder;**
- **Minimuni 1 (një) Inxhinier Mjedisi**

*Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se nuk disponon minimumi *1 (një) Inxhinier Mjedisë*, pasi inxhinieri i deklaruar si i tillë rezulton i diplomuar si Kimist Teknolog.

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “**INSTITUTI DEKLIADA – ALB**” Sh.p.k., për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1, gërma “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*“1. Ofertuesi duhet të paraqesë:...*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;”*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se *Formulari i Sigurimit të Ofertës sipas Shtojcës 3*, i paraqitur, nuk është kryer për këtë procedurë prokurimit, por i referohet një procedure tjetër të zhvilluar.

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.2.2/ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, dhe 2021, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

➤ Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se *nuk është paraqitur Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar për Bilancin e vitit 2019*, pasi përmbushen kushtet e nenit 41 të Nr.10 091, datë 05.03.2009.

III. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.1/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

*2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku*

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Krahas dokumentacionit të mësipërm të paraqitet situacioni i punimeve të ndërtimit i konfirmuar nga Autoriteti Kontraktor/Investitori për të cilin është kryer shërbimi i ngjashëm i mbikqyrjes për kontratën e paraqitur në procedurë.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se për kontratat e shërbimeve të paraqitura nuk janë paraqitur situacionet e punimeve të ndërtimit të konfirmuar nga Autoriteti Kontraktor/ Investitori për të cilin është kryer shërbimi i ngjashëm i mbikqyrjes.**

#### **IV. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.3.8/ 2.3 Kapaciteti teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:**

2.3.8 *Operatori Ekonomik krahas Formularit të Ofertës, duhet të paraqesë dhe Analizën e përlllogaritjes së ofertës, në respektim të Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.354, datë 11.05.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”, si dhe shkresës Nr.Prot.5585, datë 25.07.2017 “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikqyerje dhe Kolaudim”. Mosdorëzimi i Formularit të Ofertës së bashku me analizën e përlllogaritjes sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.354, datë 11.05.2016, është kusht për s’kualifikim.*

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e operatorit ekonomik, pasi bazuar në dokumentacionin e paraqitur, konstatohet se në Shtojcën 2 “Lista e Çmimeve të Shërbimeve” vlera e ofertuar është mbi fondin limit të shpallur për këtë procedurë prokurimi.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Informojmë Operatorin Ekonomik: **“E.B.S”** Sh.p.k., me seli: *Tiranë, Kashar, YZBERISH, Rruga “Teodor Keko”, pallati “ALES Konstruksion”, shkalla nr.1, kati 7-të.*, me numër Nipt-i: **K72014002P**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **1 791 323** (një milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e njëzet e tre) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor **“Ujësjetllës Mat” Sh.A. (Zyrës së Protokollit)**, me adresë: rruga *“Ibrahim Temo”*, lagjja *“Partizani”*, Burrel, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (*dhjetë*) ditëve nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar/ tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

**Titullari i Autoritetit Kontraktor**